Kërcet arma pas sherrit në një lokal në plazh, arrestohen 2 persona, procedohen 2 të tjerë. Ja çfarë ndodhi dje në Himarë

30 Korrik, 2023 09:52

Madhësia e tekstit:

HIMARË

Dy të arrestuar, dy të proceduar dhe një person në kërkim pas një konflikti me armë ditën e djeshme në Himarë.

Sekuestrohen 2 armë gjahu, 1 krehër arme zjarri pistoletë, 1 shenjestër optike për snaiper, 1 automjet dhe 1 aparat celular.

Shërbimet e Komisariatit të Policisë Himarë, ditën e djeshme, pas marrjes së njoftimit se në një lokal në plazhi e Bunecit, në Himarë, disa shtetas ishin konfliktuar fizikisht dhe kishin qëlluar me armë zjarri në ajër, kanë organizuar menjëherë punën me qëllim zbardhjen e plotë të ngjarjes, identifikimin dhe vënien përpara përgjegjësisë ligjore të të gjithë shtetasve të përfshirë në këtë konflikt. Falë veprimeve të shpejta hetimore u bë i mundur finalizimi i operacionit policor të koduar "Buneci", në kuadër të cilit u bë arrestimi në flagrancë i shtetasve:

– Eduart Veliu, 42 vjeç, banues në Himarë, për veprat penale "Armëmbajtja pa leje", "Kanosja" dhe "Plagosja e lehtë me dashje" (aktualisht ndodhet në spital, në rrajtje nga shërbimet e Policisë, pasi ka pësuar dëmtime fizike gjatë konfliktit);

– Nikolin Laska, 44 vjeç, banues në Himarë, për veprat penale "Veprime që pengojnë zbulimin e së vërtetës" dhe "Mbajtja pa leje e armëve të gjahut".

U shpall në kërkim shtetasi Alfred Veliu, 46 vjeç, për veprat penale "Armëmbajtja pa leje", "Kanosja" dhe "Plagosja e lehtë me dashje". Punohet për kapjen e tij.

Gjithashtu, nisi procedimi penal ndaj personit ndërsa u lirë për veprën penale "Plagosje e lehtë me dashje", për shtetasit N. L., 40 vjeç, dhe A. L., 38 vjeç, të dy banues në Himarë.

Nga veprimet hetimore dyshohet se për motive të dobëta shtetasit Eduart Veliu dhe Alfred Veliu (kushëriní) janë konfliktuar fillimisht fizikisht me shtetasit N. L. dhe A. L. (vëllezër), dhe më pas i kanë kanosur këta të fundit, duke qëlluar me armë zjarri në ajër, në ambientet e lokalit të shtetasit Nikolin Laska, i cili ka tentuar ta fshehë ngjarjen.

Gjatë kontrollit në banesën e shtetasit Nikolin Laska u gjetën dhe u sekuestruan 2 armë gjahu, ndërsa në banesën e shtetasit Eduart Veliu, shërbimet e Policisë gjetën dhe sekuestruan 1 krehër arme zjarri pistoletë, 1 shënjestër optike për snaiper. Gjithashtu, në lidhje me këtë ngjarje janë sekuestruar 1 automjet tip "Audi" dhe 1 aparat celular.

Materialet iu referuan Prokurorisë, për veprime të mëtejshme.

Për t'u bërë pjesë e grupit "**Balkanweb**" mjafton të klikoni: Join Group dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. Grupi Balkanweb

Etiketa: arme · himarë · konflikt

TË NGJASHME

EMRI/ Në kërkim për mashtrim përmes call-centrave, arrestohet i riu në Himarë
18 Korrik, 2023

Plagosja me armë pas një sherri për motive të dobëta, zbardhet identiteti i shënjestrës' dhe i autorit në arrati (EMRAT)
22 Korrik, 2023

Taboola Feed

Crypto Millionaire Warns: "Move Your Money By Jul. 26"
VisionaryProfit · Sponsored
Learn More

If you own a mouse, you will never turn off your computer again.
No Install. Play for free.
Combat Siege · Sponsored
Play Now

"Ta martoj tët ëmë", Agron Llakaj përfundon në urgjencë, zbulon episodin e pakëndshëm që i ndodhi
"Ta martoj tët ëmë", Agron Llakaj përfundon në urgjencë, zbulon episodin e pakëndshëm që i ndodhi
balkanweb.com

You will never turn off your computer again. No Install. Play for free.
PlanetMath · Sponsored

TË FUNDIT NGA -KRONIKË

Kapen me 19 kg kokainë dhe mjëra euro në banesë, arrestohen 3 shqiptarë në Itali
30 Korrik, 2023

Qëlloi me armë zjarri pas konfliktit në Durrës, ministri Balla shkarkon punonjësin e Gardës. Ndalohet nga policia
30 Korrik, 2023

Ngacmuan seksualisht dhe rrahën një të re në Greçi, arrestohen katër të mitur, mes tyre një shqiptar
30 Korrik, 2023

"Punonjësi i Gardës qëlloi në ajër me armën e shërbimit", konflikti në Hamallaj, reagon policia: Shoqëruam anëtarët e dy familjeve
30 Korrik, 2023

Aksident në aksin Fier-Kallm, makina del nga rruga dhe përfundon në kanal, detajet
30 Korrik, 2023

E rëndë në Sukth, degjeneron konflikti, dhunohen anëtarët e një familjeje. Një prej autorëve, pjesë e grupit të shoqërisë së krysparlamentares Nikolla
30 Korrik, 2023

KATEGORIA VIDEO

Aksident në aksin Fier-Kallm, makina del nga rruga dhe përfundon në kanal, detajet
30 Korrik, 2023

Video/ Ariu zhytet në pishinë për të mposhtur vapën në Kaliforni
30 Korrik, 2023

E rëndë në Sukth, degjeneron konflikti, dhunohen anëtarët e një familjeje. Një prej autorëve, pjesë e grupit të shoqërisë së krysparlamentares Nikolla
30 Korrik, 2023

VIDEO/ Vrau gruan dhe më pas veten, ja momenti kur policia rrethon zonën për kapjen e autorit në Malësi, Shihni pamjet nga operacioni
30 Korrik, 2023

Ceremoni përkujtimi në 110 vjetorin e lindjes së mjekut të njohur, Koço Gilushevi, Veliaj: Aseti numër një i qytetit janë njerëzit
30 Korrik, 2023

Hapi çarr ndaj policisë dhe më pas u vetëvra, krimi në Malësi, çfarë ndodhi me 55-vjeçarin pas ekzekutuit gruan. La një letër me...
30 Korrik, 2023

© 2023 BalkanWeb. Të gjitha të drejtat e rezervuara.